

**PYETËSOR MBI VAKSINIMIN
E STUDENTËVE DHE VITIN E
RI AKADEMIK 2021-2022**

30 Shtator, 2021

Përmbajtja

<i>Hyrje</i>	2
<i>Metodologjia</i>	2
<i>Gjetjet</i>	2
Shpërndarja sipas gjinisë	3
Shpërndarja sipas ciklit të studimit	3
Shpërndarja sipas qarkut	3
Shpërndarja sipas moshës.....	4
Shpërndarja sipas universitetit	4
<i>Analiza e gjetjeve</i>	5
Figura 1 - Mënyra e zhvillimit të mësimit (me prezencë fizike ose online).....	5
Figura 2 - Sa dakord janë studentët me urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	5
Figura 3 - Shkalla e vaksinimit	6
Figura 4 - Tipi i vaksinës	6
Figura 5 - Gatishmëria për t'u vaksinuar në këmbin të qasjes në auditor	7
Figura 6 - Vaksinim me dëshirë apo imponim	7
Figura 7 - Besimi i studentëve kundrejt stafit akademik	8
<i>Aneksi nr. 1</i>	9
Urdhri Nr.413, datë 24.09.2021, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	9

Hyrje

Ky raport është hartuar nga PortaliStudentor.al dhe nga Bordi Kombëtar Studentor. Në total, 2262 studentë të niveleve të ndryshme të studimit, nga qarqe të ndryshme si edhe nga universitete të ndryshme të Shqipërisë morën pjesë në pyetësor.

Pyetësori është realizuar një muaj pas realizimit të pyetësorit të parë, "Pyetësor mbi përshtypjen e studentëve për mësimin online dhe vitin e ri akademik 2021-2022."¹, dhe ka për qëllim të kuptojë shkallën e vaksinimit të studentët, perceptimin e studentëve për vaksinimin e detyruar, si edhe mendimin e tyre rreth urdhrin Nr.413, datë 24.09.2021, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Metodologjia

Metodologjia e zgjedhur për kryerjen e këtij studimi ka si qëllim rritjen e vizibilitetit si një mënyrë për të pasur një qasje gjithëpërfshirëse kundrejt studentëve të cilet nuk ndodhen në Tiranë. Formatin përmes të cilit u mbledhën të dhënat ishte nëpërmjet Google Forms. Pyetësori është publikuar në datën 26 shtator 2021 në rrjetet sociale të PortaliStudentor.al, të Bordit Kombëtar Studentor dhe përmes platformave të tjera elektronike.

Metodologjia e studimit është sasiore dhe marzhi i gabimit përlllogaritet në 2%. Përgjigjet për çdo pyetje të mbyllur janë shënuar në vlera dhe përqindje dhe janë paraqitur nëpërmjet grafikëve. Ky studim kishte në fokus studentët pa bërë diferencime të gjinisë, moshës apo venbanimit të tyre. Pjesëmarrës të pyetësorit janë studentë të Ciklit të Parë, Ciklit të Dytë, si edhe të programeve profesionale. Pyetësori është plotësuar nga studentë të të gjitha qarqeve në vend si edhe nga studentë të universiteteve private dhe të gjithë universiteteve publike. Pjesëmarrja në total është 2262 studentë, të cilët kanë qënë anonim gjatë plotësimit të pyetësorit

Gjetjet

- 74% (1670) e studentëve dëshirojnë që mësimi të zhvillohet tërësisht në auditor, 15% (351) dëshirojnë që mësimi të zhvillohet i alternuar, ndërsa 11% (241) dëshirojnë që mësimi të zhvillohet tërësisht online.
- 74% (1678) e studentëve janë kundër urdhrin Nr.413, datë 24.09.2021, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërsa 26% (584) janë dakord.
- 31% (701) e studentëve janë vaksinuar, 13% (283) e tyre nuk janë vaksinuar aktualisht por kanë në plan të vaksinohen, ndërsa 56% (1278) e tyre nuk janë vaksinuar.
- 78% (569) e studentëve janë vaksinuar me vaksinën Pfizer/BioNTech, 12% (87) me vaksinën Sinovac, 9% (68) me vaksinën AstraZeneca dhe 1% (3) me vaksinën Sputnik.
- 54% (388) e studentëve janë vaksinuar me imponim², 45% (318) e tyre janë vaksinuar me dëshirë, ndërsa 1% (10) shprehen se vendimi për t'u vaksinuar ka ardhur me dëshirë por që imponimi ka ndikuar në marrjen e këtij vendimit.
- 66% (929) e studentëve nuk janë të gatshëm ta kryejnë vaksinën për të pasur qasje në auditor, ndërsa 34% (470) e tyre janë të gatshëm.
- 62% (1403) e studentëve nuk kanë aspak besim se stafi akademik do të mund të menaxhojë në të njëjtën kohë mësimin në auditor dhe atë online, 34% (765) e studentëve kanë besim pjesërisht, ndërsa 4% (94) e studentëve kanë shumë besim.

¹ <https://www.portalistudentor.al/docs/2/pershtypje-studentore-raport.pdf>

² Imponim i referohet kushtit të vendosur nga Komiteti i Ekspertëve i cili parashikon që studentët duhet të vaksinohen në mënyrë që të kenë qasje në auditor.

Shpërndarja sipas gjinisë

Gjinia	Shpërndarja
Femër	1870 (82.7%)
Mashkull	392 (17.3%)

Shpërndarja sipas ciklit të studimit

Viti i studimit	Shpërndarja
Bachelor - Viti i parë	1382 (61.1%)
Bachelor - Viti i dytë	566 (25%)
Bachelor - Viti i tretë	163 (7.2%)
Master - Viti i parë	61 (2.7%)
Master - Viti i dytë	41 (1.8%)
Program profesional 2-vjeçar	49 (2.2%)

Shpërndarja sipas qarkut

Qarku	Shpërndarja
Tiranë	652 (28.8%)
Fier	246 (10.9%)
Elbasan	246 (10.4%)
Durrës	218 (9.6%)
Korçë	186 (8.2%)
Shkodër	125 (5.5%)
Kukës	122 (5.4%)
Berat	120 (5.3%)
Vlorë	115 (5.1%)
Lezhë	103 (4.6%)
Dibër	94 (4.2%)
Gjirokastrë	45 (2%)

Shpërndarja sipas moshës

Mosha	Shpërndarja
17	89 (3.93%)
18	1097 (48.5%)
19	591 (26.13%)
20	287 (12.69%)
21	97 (4.29%)
22	47 (2.08%)
23	18 (0.8%)
24+	36 (1.59%)

Shpërndarja sipas universitetit

Universiteti	Shpërndarja
Universiteti i Tiranës	767 (34.97%)
Universitet Privat	321 (14.64%)
Universiteti i Mjekësisë	230 (10.49%)
Universiteti i Durrësit	185 (8.44%)
Universiteti Politeknik i Tiranës	159 (7.25%)
Universiteti i Elbasanit	140 (6.38%)
Universiteti Bujqësor i Tiranës	109 (4.97%)
Universiteti i Shkodrës	91 (4.15%)
Universiteti i Vlorës	83 (3.78%)
Universiteti i Korçës	68 (3.10%)
Universiteti i Gjirokastrës	20 (0.91%)
Universiteti i Sporteve	14 (0.64%)
Universiteti i Arteve	6 (0.27%)

Analiza e gjetjeve

Si duhet të zhvillohet mësimi në Universitete këtë vit të ri akademik?




Figura 1 - Mënyra e zhvillimit të mësimi (me prezencë fizike ose online)

Duke synuar marrjen e një opinioni nga ana e studentëve për mënyrën se si duhet të realizohet viti i ri akademik, kemi shtruar pyetjen se si dëshirojnë studentët të zhvillohet mësimi në universitete.

74% (1670) e studentëve dëshirojnë që mësimi të kryhet tërësisht në auditor, 15% (351) e tyre dëshirojnë që mësimi të zhvillohet i alternuar midis mësimi në auditor dhe atij online, ndërkohë që 11% (241) janë në favor të zhvillimit të mësimi tërësisht online.

A jeni dakord me urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale?



Figura 2 - Sa dakord janë studentët me urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Pyetja e dytë adreson dakordësinë e studentëve me urdhrin Nr.413, datë 24.09.2021, që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka publikuar i cili detyron të gjithë studentët të jenë të vaksinuar në mënyrë që të mund të ndjekin mësimin në auditor.

Sipas urdhrin, studentët e pavaksinuar do duhet që të ndjekin mësimin në formë alternative (online), deri në momentin që ata do të vaksinohen. Referuar kësaj pyetje, 74% (1678) e studentëve nuk janë dakord me urdhrin e lëshuar nga ana e Ministrisë, ndërsa 26% (584) janë dakord.




Figura 3 - Shkalla e vaksinimit

Kur studentët janë pyetur nëse janë vaksinuar, 56% (1278) e tyre janë përgjigjur negativisht, ndërsa 31% (701) pozitivisht. Vlen të theksohet se 13% (283) e studentëve të cilët nuk janë vaksinuar aktualisht kanë në plan të vaksinohen.

Referuar pyetësorit të kaluar që PortaliStudentor.al së bashku me Bordin Kombëtar Studentor kanë zhvilluar, "Pyetësor mbi përshtypjen e studentëve për mësimin online dhe vitin e ri akademik 2021-2022"³, bie në dukje një përputhshmëri mes të dhënave të vaksinimit. Në pyetësorin e kaluar, 40% e studentëve pohonin se do të vaksinoheshin, ndërsa në pyetësorin aktual, përqindja e kombinuar e studentëve që janë vaksinuar dhe e atyre që nuk janë vaksinuar por kanë në plan të vaksinohen është 44%, duke treguar se retorika e përdorur nga institucionet përgjegjëse nuk ka rezultuar efektive.




Figura 4 - Tipi i vaksinës

Referuar F. 4, kur studentët janë pyetur se cilën vaksinë kanë kryer, 78% (569) përgjigjen se janë vaksinuar me vaksinën Pfizer/BioNTech, 12% (87) përgjigjen se janë vaksinuar me vaksinën Sinovac, 9% (68) përgjigjen se janë vaksinuar me vaksinën AstraZeneca dhe 1% (3) me vaksinën Sputnik.

³ <https://www.portalistudentor.al/docs/2/pershtypje-studentore-raport.pdf>

A jeni të gatshëm të kryeni vaksinën në mënyrë që të keni qasje në auditor?




Figura 5 - Gatishmëria për t'u vaksinuar në këmbin të qasjes në auditor

Kur studentët janë pyetur nëse janë të gatshëm të kryejnë vaksinën në mënyrë që ata të kenë qasje në auditor, 66% (929) e tyre janë përgjigjur negativisht, ndërsa 34% (470) e tyre janë përgjigjur pozitivisht.

Krahasuar me pyetjen "Nëse vaksina do të bëhej me detyrim në mënyrë që të mund të ndiqnit mësimin, çfarë do të bënit?", e cila u është drejtuar studentëve në pyetësorin e kaluar⁴ dhe ku 72% e studentëve pohojnë se do të vaksinoheshin në mënyrë që të mos humbisnin vitin akademik, fakti që mësimi do të zhvillohet online për studentët që nuk janë vaksinuar, duket se ka ndikuar në vendimmarrjen e tyre.

Jeni vaksinuar me dëshirë apo imponim?




Figura 6 - Vaksinim me dëshirë apo imponim

Pyetjes nëse vaksinimi ka ardhur si dëshirë për t'u mbrojtur kundër COVID-19 apo si imponim⁵ për të pasur mundësinë e ndjekes së mësimin në auditore, 54% (388) e studentëve shprehen se vaksinimi i tyre ka ardhur me imponim, 45% (318) shprehen se janë vaksinuar me dëshirën e tyre, ndërsa 1% (10) shprehen se vaksinimi ka ardhur me dëshirë, por se imponimi ka ndikuar në dëshirën e tyre për t'u vaksinuar.

⁴ <https://www.portalistudentor.al/docs/2/pershtypje-studentore-raport.pdf>

⁵ Imponim i referohet kushtit të vendosur nga Komiteti i Ekspertëve i cili parashikon që studentët duhet të vaksinohen në mënyrë që të kenë qasje në auditor.




Figura 7 - Besimi i studentëve kundrejt stafit akademik

Duke qënë se studentët të cilët nuk do të vaksinohen do të kenë mundësinë e ndjekjes së mësimin në formatin online, kemi pyetur studentët se sa besim kanë se stafi akademik do të mund të menaxhojë njëkohësisht mësimin në auditor dhe atë online. 62% (1403) e studentëve përgjigjen se nuk kanë aspak besim, 34% (765) e studentëve përgjigjen se kanë pjesërisht besim, ndërsa 4% (94) e studentëve përgjigjen se kanë shumë besim.

Aneksi nr. 1

Urdhri Nr.413, datë 24.09.2021, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 3951 prot.

Tiranë, më 24.09/2021

URDHËR

Nr. 413, datë 24.09.2021

**“PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19
PËR PERSONELIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE STUDENTËT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7. të nenit 18. të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, të Komitetit të ekspertëve të Imunizimit të datës 29.08.2021 si edhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot, datë 30.08.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019

URDHËROJ:

1. Të gjithë personat që rrezikohen dhe përbëjnë rrezik për të tjerët, për të penguar përhapjen e sëmundjeve infektive përbushin detyrimet e përcaktuara në nenin 18, pika 7, gërma a/ii të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar.
2. Personeli i institucioneve arsimore dhe studentët si një ndër kategoritë e përfshira në pikën 1, të këtij urdhëri, duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës dhe studentët pranë zyrave të përcaktuara nga IAL-të përkatëse, Certifikatën e Vaksimit Covid-19 nga e-albania apo kartën e vaksimit.
3. Për punonjësit e institucioneve arsimore që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksimit Covid-19 apo kartën e vaksimit, do të kërkohet paraqitja, çdo javë, e testit PCR, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2, duke filluar nga data 27.09.2021.
4. Për studentët që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksimit Covid-19 apo kartën e vaksimit, drejtuesit e Institucioneve të Arsimit Universitar të marrin masa për ofrimin e studimit në platforma alternative duke filluar nga 11.10.2021.
5. Institucionet arsimore të identifikojnë personelin e institucionit arsimor dhe studentët që kanë depozituar Certifikatën e Vaksimit Covid-19 apo kartën e vaksimit dhe të raportojnë pranë Institutit të Shëndetit Publik informacion mujor mbi identifikimin e kryer.

Adresa: Rruga e Kavajës Nr 1001, Tirana, Albania. Tel: +355 42376178/ext 72128 www.shendetesia.gov.al

6. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në këtë urdhër bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.
7. Instituti i Shëndetit Publik të marrë masat dhe të monitorojë mbulimin vaksinal të grupet e përmendura në pikën 2 të këtij Urdhri dhe të raportojë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
8. Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik të bashkëpunojnë me institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij Urdhri.
9. Ky urdhër i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI
Ogerta Manastirliu

